



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Mr.faq/Bi.str. 217
Data/Datum. 20. 11. 2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Fushë Kosova



Datë: 20.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 915, të datës 22.10.2018, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 18, të Ligjit për Shëndetësinë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 915, të datës 22.10.2018 për ndryshim-plotësimin e nenit 9, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë Nr. 140, të datës 29.09.2017, me plotësimin për sektorin konsultativ lidhur me shërbimet për pediatriinë dhe gjinekologjinë, si dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, do të ofron informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik dhe të interesuarit tjerë lidhur me aspektet e konsultimeve, për shërbimet që ofrohen në Qendrën shëndetësore për pediatriinë dhe gjinekologjinë në diskutimin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së së SHMS dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

[Signature]





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIRECTION OF ADMINISTRATION	
Nr.faq/Br.str.		216
Date/Datum.		20. 11. 2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		



Datë: 20.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1575, të datës 31.10.2018, paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, të 'Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së paluajtshme të komunës', Nr. 04/L-144, Gazeta Zyrtare 35/2012), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për bartjen e pronave shoqërore në prona komunale

1. Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 1575, të datës 31.10.2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për bartjen e pronësisë së Ngastrave Kadastrale nga prona shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës', si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. 00776-1, në sipërfaqe prej 19248m², në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. 00776-2, në sipërfaqe prej 5430m², në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
2. Bartja e Ngastrave Kadastrale, të cekura në pikën 1.1 dhe në pikën 1.2 sipas vendimit në pronësi të komunës, i mundësojnë Komunës së Fushë-Kosovës ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik për zhvillimin e infrastrukturës së sportit në Stadiumin e Futbollit 'Ekrem Graiçevci' në Fushë-Kosovë.
3. Lista e Ngastrave Kadastrale me certifikatat mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme janë pjesë e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP-së dhe Arkivit.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë, Directorate for Administration. It includes the number 215 and the date 20.11.2018.

Datë: 20.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 201, të datës 31.10.2018, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryetare i grupit;
 - 1.2 Nuriye Fazliju - Drejtore e Administratës;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Remzi Shala - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
 - 1.5 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e LVV-së, anëtare;
 - 1.6 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
 - 1.7 Driton Hasolli - Përfaqësues i AKR-së, anëtar;
 - 1.8 Migjen Kolshi - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
 - 1.9 Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane, anëtar.
2. Detyrë e Grupit Punues është hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivit.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 21.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 951, të datës 29.10.2018, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, paragrafi 5.2, nenin 8, paragrafi 8.2, të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare 31/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi'

1. Për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi' për periudhën e ardhshme trevjeçare si vijon:
 - 1.1 Ilir Hasani - përfaqësues i LDK-së, ekonomist i diplomuar, anëtar;
 - 1.2 Durim Hajra - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, ekonomist i diplomuar, anëtar;
 - 1.3 Ekrem Berjani - përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës, ekonomist i diplomuar, anëtar.
2. Detyrë e Komisionit Komunal të Aksionarëve është veprimi në emër të Komunës së Fushë-Kosovës për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës tonë, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi' në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrje publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Br.str. 220
Date/Datum. 21. 11. 2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datë: 21.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 949, të datës 29.10.2018, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 3, të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L-106, (Gazeta Zyrtare 18/2012), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të propozimit për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 949, të datës 29.10.2018, për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Fushë-Kosovës me status publik.
2. Kryerja dhe vazhdimi i procedurave tjera për themelimin e teatrit të qytetit të Fushë-Kosovës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së së KRS dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë, Kosovo. It includes the text: REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA, KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE, DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU. It also contains handwritten information: Nr.faq/Br.stk. 221, and Date/Datum 21. 11. 2018.

Datë: 21.11.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.11.2018, pas shqyrtimit të Rekomandimit të Komitetit për Politikë e Financa, Nr. 178, të datës 09.10.2018, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ridestinimin e objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve në objekt për Arkivin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Rekomandimit të Komitetit për Politikë e Financa Nr. 178, të datës 09.10.2018, për ridestinimin e objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve në sipërfaqe prej 226 m² me lokacion në oborrin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në rrugën 'Aziz Zhilivoda', hapësira publike afër Sallës së Sportit, në objekt për Arkivin e Komunës së Fushë-Kosovës për plotësimin e nevojave për sistemimin e dokumentacionit zyrtar të komunës.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

